VENDIM
Nr. 273, datë 28.12.2020

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR BURIMET DYTËSORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 70, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 26, të "Rregullores për organizimit, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/16 prot., datë 24.12.2020 të hartuar nga drejtoritë teknike në lidhje me draftin e "Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 184, datë 20.11.2019, ka filluar procedurat për miratimin e Rregullores për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 32/52 prot., datë 25.11.2019, ka publikuar për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 22.11.2019. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve punë.

- Me shkresën nr. 791 prot., datë 5.12.2019, ERE ka dërguar "Rregulloren për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike", për marrje mendimi pranë subjekteve: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

- Me shkresën nr. 10365/1 prot., datë 24.12.2019, MIE është shprehur parimisht dakord mbi vendimin e ERE-s nr. 184/2019.

- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit është shprehur se ERE duhet të jetë diktuese ndaj OSHEE sh.a. në mënyrë që Rregullorja për Burimet Dytësore të Energjisë të mos cenojë të drejtën e konsumatorit për furnizim të pandërprerë me energji elektrike dhe të drejtën e tij për mundësinë e zgjedhjes së burimit të furnizimit me energji elektrike, duke krijuar kushtet për burime alternative furnizimi.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), me shkresën nr. 678 prot., datë 4.2.2020, ka dërguar në ERE plotësimin e informacionit të kërkuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.11.2019.

- Rregullorja është e shoqëruar nga 3 Shtojca të cilat përcaktojnë Standardet e Përgjithshme Elektrike, Cilësinë e Energjisë Elektrike, Tarifat e Aplikueshme dhe deklaratat e konformitetit të impiantit të burimit dytësor.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike.
2. Shoqëria OSSH sh.a. brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje të bëjë vlerësimet përkatëse për kostot lidhur me instalimin e burimeve dytësore.
3. Shoqëria OSSH sh.a., brenda datës 30.4.2021, të depozitojë në ERE për shqyrtim, vlerësimet për kostot lidhur me instalimin e burimeve dytësore.
4. Nëse kostot e vlerësuara nga OSSH sh.a. do të rezultojnë në tarifa të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë vendim, ERE do të kryejë rishikimin e tyre në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
5. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR BURIMET DYTËSORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
Miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. XXX, datë XX.XX.2020

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në përputhje me dispozitat e nenit 70, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kushtet teknike për instalimin nga klientët fundorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për të mundësuar furnizimin me energji elektrike në rastet kur ndërpritet furnizimi kryesor nga rrjeti i shpërndarjes.

Neni 3
Subjektet

Kjo rregullore zbatohet për çdo klient fundor që dëshiron të instalojë një burim dytësor të energjie rezervë dhe që është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes pavarësisht nivelit të tensionit dhe statusit të tij.

Neni 4
Përcaktime

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore, të cilët janë përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin energjisë elektrike", i ndryshuar, do të kenë kuptimin e përcaktuar në ligj.

2. Termat e përdorur në këtë rregullore, të përcaktuar në ligjin nr. 43/4015, kanë kuptimin e mëposhtëm:

- Aplikim – do të quhet paraqitja e kërkesës dhe e dokumentacionit pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, që paraqitet nga një klient për instalimin e një burimi dytësor.

- Burim dytësor – është një burim rezervë për prodhimin e energjisë elektrike pjesë e instalimeve të brendshme të klientit i palidhur me rrjetin elektrik të shpërndarjes dhe që ndalohet të punojë në paralel me të.

- Çelës ngarkese kryesor – është pajisja elektrike që është në gjendje të kyçë dhe ndërpresë (shkyçë) objektin e klientit, përkatësisht në kushtet e qarkut normal dhe, kur specifikohet, në kushtet e dhëna të mbingarkesës, defekteve në lidhje të shkurtër, mungesës së tensionit në rrjetin shpërndarës, dëmtimit të izolacionit në rrjet apo në impiant.

- Çelësi i transferimit të ngarkesës – është çelësi që kryen transferimin e ngarkesës nga një burim tek tjetri, respektivisht nga burimi kryesor rrjeti i shpërndarjes në burimin dytësor të instaluar nga klienti, i cili mund të jetë manual, automatik ose i kombinuar, që realizon skema manovrimi të ndryshme, në kushtet e operimit pa tension.

- Frekuenca – është numri i cikleve alternativ të rrymës për sekondë në të cilën funksionon sistemi elektroenergjetik (matet me Hz).

- Fuqia aktive (P) – është vlera mesatare e marrë, për një periudhë periodike, e produktit të menjëhershëm të rrymës dhe tensionit e shprehur në W.

- Fuqia e plotë (S) – është produkti i tensionit r.m.s. dhe rrymës r.m.s. në elementin ose qarkun e shprehur në VA.

- **Leje** – është një leje apo autorizim e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse me qëllim instalimin dhe ndërtimin e një burimi dytësor rezervë.

- Mbrojtja – është sistemi i masave për parandalimin e kushteve jonormale gjatë punës së burimit dytësor rezervë.

- Mbrojtja në pikën e instalimit të burimit dytësor – është mbrojtja elektrike e nevojshme për të siguruar që objekti i klientit të shkyçet për çdo ngjarje që mund të dëmtojë integritetin ose të dëmtojë sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit elektrik shpërndarës.

- **Ngarkesë** – është një ose më shumë pajisje elektrike ose klient që marrin fuqi elektrike nga sistemi elektroenergjetik. Ngarkesa është e ndryshme nga Kërkesa për energji elektrike, e cila është sasia e matur e fuqisë që kërkon ose merr ngarkesa në KW, MW ose KVA, MVA.

- **Pika e instalimit të burimit dytësor** – është vendi me koordinatat gjeografike, përfshirë adresën dhe vendndodhjen e saj në një objekt ose jashtë tij, në të cilin është instaluar burimi dytësor.

- **Procesi i instalimit** – është procedura teknike që ndiqet për të mundësuar instalimin e burimit dytësor rezervë të energjisë elektrike.

- **Testet** – janë teste që kryen nga OSSH-ja, që përfshijnë kushtet e simulimit ose kontrollin e zbatimit të rregullave standardeve të instalimit dhe funksionimit të burimit dytësor rezervë.

- **Verifikimi** – është tërësia e të gjitha masave me anë të të cilave kontrollohet përputhshmëria e instalimit elektrik me standardin e kërkuar.

KAPITULLI II
KUSHTET DHE STANDARDET TEKNIKE TË SIGURISË

Neni 5
Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

1. Për të garantuar operimin e sigurt dhe qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes klientët fundor që kërkojnë të instalojnë një burim dytësor të energjisë elektrike duhet të zbatojnë kërkesat e Kodit të Shpërndarjes për lidhjen, operimin dhe mirëmbajtjen e burimit dytësor.

2. Për projektimin, instalimin dhe operimin e një burimi dytësor, kërkesat minimale të domosdoshme lidhur me sigurinë e operimit të tyre, janë:

a) të gjitha shtesat, modifikimet ose ri-konfigurimet në instalimet e brendshme elektrike të klientit që nevojiten për instalimin e burimit dytësor duhet të kryhen nga një person i licencuar;

b) për çdo modifikim të pikës së instalimit të burimit dytësor duhet marrë miratimi paraprak nga OSSH-ja;

c) instalimi i burimit dytësor duhet të projektohet, instalohet, testohet, kolaudohet në përputhje me standardet teknike të aplikueshme, në veçanti, IEC 60364, të cilat jepen në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Mbrojtjet kryesore të burimit dytësor

1. Në fazat e projektimit, instalimit dhe operimit të një burimi dytësor duhet të sigurohet mbrojtja e tij nga:

a) punimi paralel me burimin parësor të furnizimit nga rrjeti i shpërndarjes;

b) funksionimi jokorrekt i sinkronizimit;

c) mbingarkesa;

d) lidhjet e shkurtra;

e) lidhjet me tokën;

f) rrymat në nivele mbi ato të lejuara;

g) ndryshimi i tensionit përtej vlerave të lejuara;

h) ndryshimi i frekuencës përtej vlerave të lejuara;

i) shkarkimet atmosferike dhe mbitensionet e induktuara.

2. Kërkesat themelore për projektimin e skemave të mbrojtjes janë si më poshtë:

a) sistemi i mbrojtjes do të sigurojë që çdo defekt i brendshëm në instalimin dhe operimin e burimit dytësor nuk shkakton probleme dhe pasoja te rrjeti i shpërndarjes dhe përdoruesit e tjerë të këtij rrjeti;

b) sistemi i mbrojtjes do të sigurojë që çdo defekt i rrjetit të shpërndarjes nuk shkakton efekte dëmtuese për burimin dytësor.

3. Klienti që instalon burimin dytësor, garanton dhe është përgjegjës për kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes gjatë operimit të burimit dytësor.

4. Në rastet e dështimit të mbrojtjes, që mund të vijnë nga dështimi i pajisjeve mbrojtëse apo të kontrollit dhe/ose humbjes së fuqisë së kontrollit, burimi dytësor duhet të shkëputet menjëherë nga operimi.

Neni 7

Mbrojtja rele e burimit dytësor

1. Për të rritur shkallën e sigurisë gjatë operimit të një burimi dytësor, OSSH-ja mund të kërkojë nga klienti fundor që planifikon të instalojë një burim të tillë, pajisjen me mbrojtje rele kohe dhe/ose drejtimi fuqie të burimit dytësor.

2. Releja e kohës duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) koha maksimale e lejuar për punimin në paralel është 1 sekondë ose 60 cikle;

b) releja e kohës për të shmangur punimin në paralel, duhet të jetë e aftë të veprojë ndaj mbrojtjes shtesë që duhet të veprojë mbi çelësin e burimit dytësor rezervë ose të çelësit kryesor.

3. Releja e drejtimit të fuqisë duhet të instalohet në anën e klientit (në anën sekondare të transformatorit) dhe duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) releja duhet të tarohet që të jetë e aftë të veprojë në çelësin e burimit dytësor rezervë ose në çelësin kryesor.

b) releja duhet të tarohet dhe të jetë e aftë që të dedektojë rrymën e magnetizimit të transformatorit të shpërndarjes pas energjizimit.

4. Në rast se kërkohet pajisja me rele mbrojtëse, ato do të jenë pjesë e testimit dhe komisionimit nga përfaqësuesit e OSSH-së.

Neni 8

Çelësi i transferimit të ngarkesës

1. Çdo burim dytësor duhet të jetë i pajisur me çelësin elektrik të transferimit të ngarkesës nga një burim i energjisë elektrike tek tjetri.

2. Çelësi elektrik i transferimit të ngarkesës mund të jetë manual, automatik ose i kombinuar. Ai duhet të zgjidhet në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe në funksion të:

a) ngarkesës maksimale;

b) rrymës maksimale të lidhjes së shkurtër.

Çelësi automatik i transferimit të ngarkesës (*Automatic Transfer Switch* – ATS) instalohet shpesh aty ku gjendet burimi dytësor, në mënyrë që burimi të mund të sigurojë përkohësisht energji elektrike nëse energjia elektrike nga rrjeti i shpërndarjes ndërpritet ose mungon.

3. Në varësi të llojit të klientit, ekzistojnë tri metoda përzgjedhëse që garantojnë kalimin e sigurt të ngarkesës nga një burim i energjisë elektrike tek tjetri, siç përcaktohen më poshtë:

a) Transferim/Kontakt i Hapur/Shkyçur nëpërmjet një çelësi me dy pozicione.

Në këto lloj çelësash ngarkesa duhet të shkëputet paraprakisht nga një burim para se të lidhet me burimin tjetër. Ky lloj çelësi gjen zbatim për ngarkesa të karakterit induktiv të ulët dhe jo të rëndësisë së veçantë.

b) Transferim/Kontakt i Vonuar/Programuar nëpërmjet një çelësi me dy pozicione.

Ky lloj çelësi përdoret me ngarkesa të karakterit induktiv të tilla si ngarkesa motorike dhe transformatorët. Ngarkesa shkëputet nga një burim, pastaj ndalon për një kohë të programuar në një pozicion "të fikur" (*off*) para kontaktit/lidhjes me burimin tjetër me qëllim për t'u mbrojtur nga mbi-tensionet e krijuara gjatë procesit kalimtar.

Çelësi me kalim të vonuar gjithashtu mund të përdoret me opsionin e shkarkimit të ngarkesës për kategori klientësh jo të rëndësisë së veçantë.

c) Transferim/Kontakti i Mbyllur/Kyçur nëpërmjet një çelësi me tri pozicione.

Çelësat e transferimit/kalimit të mbyllur përdoren për instalimin e burimeve dytësore nga klientët/përdoruesit për të cilët ndërprerja e furnizimit me energjie elektrike përbën rrezik për jetën e njerëzve dhe mund të shkaktojë dëmtimin e pajisjeve apo humbjen e të dhënave elektronike, prishjen e prodhimit për shkak të ndërprerjes së proceseve teknologjike etj.

Çelësi automatik i transferimit të ngarkesës duhet të jetë i pajisur me funksion shtesë, në rast të refuzimit të veprimeve të kontakteve për të parandaluar funksionimin paralel të burimit dytësor me rrjetin e shpërndarjes.

Kontrollet për kalimin e transferimit duhet të parandalojnë operimin paralel të burimit të klientit dhe sistemit elektrik të OSSH-së për një periudhë jo më të gjatë se një sekondë (60 cikle).

KAPITULLI III
PROCEDURAT E NJOFTIMIT/MIRATIMIT, INSTALIMIT DHE TESTIMIT TË BURIMEVE DYTËSORE REZERVË

Neni 9
Njoftimi i OSSH-së për instalimin

1. Çdo klient që dëshiron të instalojë një burim dytësor për t'u furnizuar me energji elektrike duhet të njoftojë OSSH-në të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara instalimit të burimit dytësor lidhur me synimin e tij për këtë instalim.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e klientit;

b) adresën dhe vendndodhjen e objektit ku do të instalohet burimi dytësor;

c) një përshkrim i detajuar i burimit dytësor;

- planimetria e vendosjes së burimit dytësor;
- dokumentacioni i konfigurimit të burimit dytësor;
- specifikimet teknike, përfshirë tipin dhe kapacitetin e burimit;

- sistemet e emergjencës;

d) një përshkrim i detajuar i sistemeve të tij të kontrollit;

e) dokumentacionin teknik të çelësit të transferimit të ngarkesës;

f) dokumentacionin teknik të pajisjes sinkronizuese;

g) skemat elektrike të instalimit dhe lidhjes së burimit dytësor;

h) identifikimin e të gjitha mbrojtjeve kryesore;

i) një përshkrim të rendit të ngjarjeve për operacionin e transferimit dhe specifikimet për çdo pajisje mbrojtëse të kërkuar nga OSSH-ja;

j) kopje të dokumentacionit origjinal teknik të lëshuar nga prodhuesi i burimit dytësor;

k) çdo informacion tjetër teknik të disponueshëm që ka lidhje me burimin dytësor;

l) data kur parashikohet të vihet në funksion burimi dytësor.

Neni 10

Mundësia e kërkimit të miratimit nga OSSH-ja

1. Klienti fundor që dëshiron të instalojë një burim dytësor të energjisë elektrike mund të kërkojë nga OSSH-ja vlerësimin e projektit teknik të instalimit të burimit dytësor, përfshirë miratimin e tij nëse e gjen në përputhje me të gjitha kushtet dhe standardet teknike në fuqi.

2. Një kërkesë për miratim sipas këtij neni mund të bëhet përpara ose të kombinohet me njoftimin sipas nenit 9.

3. Kërkesa për miratim shqyrtohet nga OSSH-ja, nuk do të jetë më shumë se 20 ditë pune prej datës së paraqitjes.

Neni 11

Sigurimi i dokumentacionit të plotë

1. Në rastet kur informacioni dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për një njoftim sipas nenit 9 ose miratimi sipas nenit 10 nuk është i plotë apo kur OSSH-ja gjykon se është i nevojshëm paraqitja e informacionit dhe/ose dokumentacionit shtesë për instalimin e një burimi dytësor, ajo mund t'i kërkojë klientit paraqitjen e informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar brenda një afati kohor të arsyeshëm, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 10.

2. OSSH-ja, pas dorëzimit të informacionit dhe dokumentacionit të munguar ose shtesë nga ana e klientit fundor, shprehet mbi kërkesën e paraqitur brenda 5 (pesë) ditëve pune.

Neni 12

Lejet dhe autorizimet nga institucione përkatëse

Në çdo rast, klienti duhet të marrë lejet dhe miratimet që kërkohen nga autoritetet përkatëse për instalimin e një burimi dytësor që mund të përfshijnë:

- leje nga autoritetet lokale;

- miratime të tjera nga organet përkatëse.

Neni 13

Instalimi i burimit dytësor

1. Klienti mund të vijojë me instalimin e burimit dytësor 30 (tridhjetë) ditë mbas dërgimit të njoftimit sipas nenit 5 ose menjëherë mbas marrjes së miratimit nga OSSH-ja sipas nenit 6.

2. Instalimi i burimit dytësor duhet të kryhet nga një person i licencuar.

Neni 14

Deklarimi i konformitetit

Pas instalimit të burimit dytësor, personi përgjegjës për instalimin, lëshon dhe nënshkruan një deklaratë të konformitetit në të cilën konfirmohet, se:

a) instalimi i burimit dytësor është bërë në mënyrë profesionale;

b) instalimi i burimit dytësor është bërë sipas projektit të paraqitur dhe miratuar nga OSSH-ja dhe çdo ndryshim nga projekti, nëse ka, nuk e përkeqëson pajtueshmërinë, performancën dhe sigurinë e rrjetit të shpërndarjes. Çdo ndryshim projektit i raportohet OSSH-së sipas deklaratës së konformitetit;

c) të gjitha materialet, komponentët dhe pajisjet e përdorura në instalimin e burimit dytësor janë përzgjedhur sipas projektit dhe përmbushin kërkesat dhe rregullat teknike në fuqi.

Neni 15

Njoftimi i instalimit

Menjëherë pas përfundimit të instalimit të burimit dytësor, klienti njofton me shkrim OSSH-në.

Neni 16

Testimi dhe komisionimi i instalimit të burimit dytësor

1. Bashkë me njoftimin për përfundimin e punimeve të instalimit sipas nenit 14, klienti i dërgon OSSH-së një plan testimi dhe komisionimi të detajuar për burimin dytësor të instaluar.

2. Testimi dhe komisionimi i instalimeve të burimit dytësor bëhet jo më vonë se 28 ditë nga njoftimi i përfundimit të punimeve të instalimit.

3. Testimet dhe komisionimi i burimit dytësor kryhen nga inxhinierë të licencuar, të certifikuar, të autorizuar nga klienti dhe gjithmonë në prani të përfaqësuesve të OSSH-së.

4. Gjatë fazës së testimit kryhen dy lloje testesh:

a) Testet e përputhshmërisë së parametrave të burimit dytësor

Klienti është përgjegjës për të vërtetuar që burimi dytësor dhe parametrat e tij janë përmbushin kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe të standardeve teknike në fuqi.

b) Testet e pajtueshmërisë me rregullat dhe standartet teknike të lidhjeve elektrike të brendshme.

Testet duhet të konfirmojnë se lidhja është bërë sipas skemës së miratuar, instalimet janë në përputhje me standardet teknike, tarimet janë vendosur sipas kufijve të parashikuar sipas standardeve teknike dhe se lidhja e burimit dytësor nuk sjell pasoja të dëmshme në funksionimin e rrjetit të shpërndarjes.

5. Për komisionimin/vënien në punë duhet të kryhen testet e mëposhtme:

a) garantimi që burimi dytësor nuk punon paralel me sistemin e shpërndarjes;

b) funksionimi i çelësit të transferimit të ngarkesës;

c) skemat e ndërlidhjes së mbrojtjeve, burim dytësor – rrjet shpërndarje (nëse ka);

d) testet funksionale të pajisjeve të përdorura;

e) matjen e parametrave të cilësisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga burimi dytësor.

6. Gjatë procesit të testimit dhe komisionimit të burimit dytësor dhe instalimeve të tij duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur ndikimet e dëmshme në funksionimin e rrjetit të shpërndarjes.

Neni 17

Lidhja me rrjetin e shpërndarjes

1. Mbas përfundimit të testimeve, nëse nga ana e OSSH-së nuk ka asnjë vërejtje, klienti mund të lidhë burimin dytësor në skemën elektrike.

2. OSSH-ja dhe klienti lidhin një marrëveshje lidhje në të cilën përcaktohen standardet dhe kërkesat minimale teknike të lidhjes dhe operimit të burimit dytësor.

3. OSSH sh.a. duhet të përgatisë një kontratë standarde që do të përdoret për marrëveshje lidhje dhe operim të burimeve dytësore. Kjo marrëveshje duhet të aplikojë parime dhe njëjta për të gjithë klientët fundorë dhe të garantojë trajtimin e barabarte të klientëve fundorë.

Neni 18
Instalimi i burimit dytësor në një objekt të ri

Në rast se një burim i dytësor planifikohet të instalohet në një objekt të ri, projekti i burimit dytësor do të integrohet me projektin e përgjithshëm elektrik të objektit dhe instalimi dhe testimi i tij do të kryhet në të njëjtën kohë me instalimet e tjera elektrike të objektit në përputhje me Rregullat e lidhjeve të reja.

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË TJERA

Neni 19
Lehtësimi i inspektimit

1. Klienti fundor është i detyruar të mundësojë inspektimin e burimit dytësor nga OSSH-ja në çdo kohë mbas instalimit të tij.

2. Klienti fundor i paraqet OSSH-së të gjithë dokumentacionin përkatës teknik, nëse kjo është e nevojshme dhe kërkohet për qëllim të inspektimit.

Neni 20
Instalimi i paautorizuar

OSSH-ja ka të drejtë të ndërmarrë masa deri në shkëputjen e lidhjes me rrjetin te klienti fundor në rast se klienti fundor nuk përmbush detyrimet e parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje, dhe vijimi i lidhjes së tij me rrjetin cenon sigurinë e operimit të rrjetit të shpërndarjes. Për raste të tilla, OSSH-ja duhet brenda 3 ditëve të realizimit të ndërprerjeve të informojë ERE.

Neni 21
Shkelja e rregullave teknike gjatë operimit

1. Në rast se OSSH-ja gjatë një inspektimi konstaton se burimi dytësor i instaluar operohet në shkelje të rregullave teknike të operimit, ajo njofton me shkrim klientin për këtë shkelje dhe i jep kohën e nevojshme për shmangien e shkeljes.

2. Në rast se një kërkesë e tillë do të injorohet apo masat e marra nuk janë të mjaftueshme për të shmangur shkeljen ose në rast të shkeljeve të përsëritura, OSSH-ja mund të shkëpusë klientin deri kur shkelja të jetë eliminuar.

3. Në rast se shkelja kërcënon operimin normal dhe të sigurt të rrjetit apo përbën rrezik për jetën dhe pasurinë e personave të tretë, OSSH-ja mund ta shkëpusë klientin pa asnjë paralajmërim.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Bordit të ERE-s dhe hyn në fuqi menjëherë, sipas dispozitave të përcaktuara në këtë vendim.

SHTOJCË 1
STANDARDE TË PËRGJITHSHME ELEKTRIKE

IEC 60364-5-55	Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike - Pajisjet e tjera.
EC60364-7-715:2011	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-715: Kërkesat për instalime ose vendndodhje specifike - Instalime ndriçimi me tension të ulët.
IEC 60664-1	Koordinimi i izolimit për pajisjet brenda sistemeve të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet, kërkesat dhe provat.
IEC 60909-1	Rrymat e qarkut të shkurtër në tri faza a.c. të sistemeve - Pjesa 1: Faktorët për llogaritjen e rrymave të qarkut të shkurtër sipas IEC 60909-0.
IEC 60909-0:2016	
IEC 62305-3	Mbrojtja ndaj rrufesë - Pjesa 3: Dëmtimi fizik i strukturave dhe rreziku për jetën.
IEC 60364-1	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet bazë, vlerësimi i karakteristikave të përgjithshme, përkufizimet.
IEC 60364-5-54	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-54: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike – Sistemimi i tokëzimit dhe përcjellësit mbrojtës.
IEEEC 37.90	Standardi IEEE për reletë dhe sistemet rele që lidhen me aparatet e energjisë elektrike.

Cilësia e energjisë elektrike

IEC 61000-3-2	Përputhshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 3-2: Kufijtë - Kufijtë për emetimet e rrymës harmonike (rryma e hyrjes së pajisjeve ≤16 A për fazë).
IEC 61000-3-3	Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 3-3: Limitet - Kufizimet e ndryshimeve të tensionit, luhatjeve të tensionit dhe luhatjeve të mëdha të tensionit në sistemet publike të furnizimit me energji me tension të ulët, për pajisje me rrymë të vlerësuar <=16 A për fazë dhe që nuk janë subjekt i lidhjes së varur.
IEC 61000-6-1	Përputhshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6-1: Standardet gjenerike - Standardi për ambiente banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë.
IEC 61000-6-3	Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6-3: Standarde të përgjithshme - Standarde për emetimet në mjedise banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë.
IEEE519-1992	IEEE Rekomandoi praktikën dhe kërkesat për kontrollin e harmonizimit të sistemeve të energjisë elektrike, Instituti i Inxhinierëve Elektrik dhe Elektronik, Piscataway, NJ. prill 1992.

SHTOJCË 2
TARIFAT E APLIKUESHME

1. Klienti ekzistues, i cili kërkon të instalojë burimin dytësor

T1 është tarifë fikse, lidhur me kostot e aplikimit, kontrollin e dosjes nga ana e dokumentacionit, studimin dhe vlerësimin e dokumentacionit, për implementimin e burimit dytësor.

a) Për klientët familjarë - T1 = 1000 lekë

b) Për klientët jofamiljarë në tension të ulët - T1 = 5000 lekë

c) Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20 kV – T1 = 23000 lekë

d) Për klientët e lidhur në 35kV = 30 000 lekë

Tarifa T2 = 0

Tarifa T3 = 0

Tarifa T4 = 1500 lekë (tarifë azhurnimi, inspektimin në terren)

2. Klienti kërkon lidhje të re ose modifikim lidhje dhe instalim të burimit dytësor

Në raste të tilla preventivat do të përgatiten dy preventiva një për lidhjen e re dhe një për instalimin e burimit të dytë.

1. Tarifa e lidhjes së re do të jete konform tarifave të miratuara në rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes".

2. Tarifa për implementimin e burimit të dytë.

a) Për klientët familjarë - T1 = 1000 lekë

b) Për klientët jofamiljare në tension të ulët - T1 = 5000 lekë

c) Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20 kV – Tl = 23000 lekë

d) Për klientët e lidhur në 35kV = 30 000 lekë

Tarifa T2 = 0

Tarifa T3 = 0

Tarifa T4 = 500 lekë (Pasi inspektimi në terren behet në të njëjtën kohë me lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes)

SHTOJCË 3

DEKLARATE KONFROMITETI E IMPIANTIT TË BURIMIT DYTËSOR

Klienti:_____

Adresa:_____

Nr. i kontratës:_____

Përshkrimi: Sistemi i ri i burimit dytësor për furnizimin me energji elektrike të objektit, ndërtesë banimi me fuqi të kërkuar *5* kW.

Kopje për: Klientin / OSSH / Protokoll

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Aprovuar:

Z. Emër Mbiemër

Nr. Datë ___.___._____

DEKLARATË KONFROMITETI E IMPIANTIT TË BURIMIT DYTËSOR

Unë i nënshkruari Emër Mbiemër, Titullar/Përfaqësues ligjor i shoqërisë Shoqëria sh.p.k. Operator në sektorin_____, me seli në: Adresa e subjektit_____

Zotërues i impiantit elektrik të burimit dytësor: Emërtimi i impiantit_____

Lloji i impiantit:

Impiant i ri: _____

Impiant ekzistues: _____

Fusha e përdorimit të impiantit të burimit dytësor:

Familjar: _____

Privat: _____

Objekt i rëndësisë së veçantë: _____

Impianti është instaluar në: _____

DEKLAROJ:

Nën përgjegjësinë time personale se:

- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është bërë në mënyrë profesionale, nga ekspert elektrik, i licencuar i certifikuar nga organet kompetente;
- instalimi i impiantit elektrik të burimit dytësor është bërë sipas projekti të paraqitur pranë OSSH-së;
- instalimi i impiantit elektrik të burimit dytësor nuk ndikon në performancën dhe sigurinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të OSSH-së;
- të gjitha materialet dhe pajisjet elektrike të përdorura në instalimin e burimit dytësor janë përzgjedhur sipas projektit dhe përmbushin kërkesat dhe rregullat teknike në fuqi;
- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8734 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", i ndryshuar, rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik, Standardit IEC të paraqitura në rregullore;
- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është kontrolluar nga ana e sigurisë dhe funksionalitetit sipas kërkesave ligjore në fuqi. Janë instaluar të gjitha mbrojtjet përkatëse. Rezultati i kontrollit ka qenë:_____;
- si zotërues dhe shfrytëzues i burimit dytësor të energjisë, mbaj çdo përgjegjësi në lidhje me aksidentet ndaj njerëzve apo dëmeve, të shkaktuara nga mosfunksionimi normal i burimit dytësor, ose nga mosmirëmbajtja e impiantit të burimit dytësor të energjisë.

Instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor me të dhënat e mëposhtme:

- Modeli:
- Fuqia kVA – kw:
- Numri serial:
- Viti i ndërtimit:
- Niveli i zhurmës:
- Lartësia maksimale:
- Temperatura maksimale:

Impianti është konform rregullave teknike në fuqi dhe është i gatshëm për t'u lidhur në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike të OSSH-së.

Bashkëlidhur kësaj deklarate gjeni dokumentacionin si më poshtë:

- Projekti elektrik i impiantit të burimit dytësor, përfshi skemat elektrike të lidhjes së burimit dytësor me rrjetin e shpërndarjes së OSSH-së.
- Planimetria e vendosjes se burimit dytësor në objekt.
- Dokumentacioni i konfigurimit të burimit dytësor
- Specifikimet teknike të burimit dytësor të energjisë, tipi, kapaciteti etj.
- Sistemet e emergjencës të burimit dytësor të energjisë.
- Relacioni teknik i sistemeve të kontrollit të burimit dytësor.
- Dokumentacioni teknik i çelësit të transferimit të ngarkesës.
- Dokumentacioni teknik i pajisjes sinkronizuese.
- Verifikimi i kryer nga eksperti elektrik të licencuar i certifikuar.
- Kopje e dokumentacionit origjinal teknik të lëshuar nga prodhuesi i burimit dytësor.

Certifikata që lëshohen nga institucione të tjera jashtë OSSH-së në lidhje me ndotjen akustike; ndotjen mjedisore për sa i përket ndikimit në mjedis të burimit dytësor që do të instalohet.

Deklaruesi
Emër Mbiemër